

V E N D I M
Nr.445, datë 25.12.1990

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.70, DATË 11.3.1985 "PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE
QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE"**

Me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.3.1985, në nenin 1, bëhen këto ndryshime:

-Në shkronjën "a" shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:"Mallrat e konsumit të gjerë që merren në dorëzim edhe me peshimin e tyre bruto, caktohen nga Ministria e Tregtisë së Brendshme, duke marrë mendimin dhe të ministrave të tjera prodhuese".

- Në shkronjën "b" pas fjalëve "peshimin e tyre bruto" shtohet fjalët "ose me numërim, sipas natyrës së mallit".

- Në shkronjën "b" shtohet një paragraf me këtë përmbajtje :

"Vlerat materiale me ambalazh të mbyllur standard dhe jo standard të jenë të pajisura me etiketa brenda ambalazhit, në të cilin shënohet sasia e cilësia e mallit, emërtimi i tij dhe çmimi, si dhe emri e mbiemri i ambalazhuesit, shënja dalluese e tij dhe nënshkrimi".

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i tretë ndryshohet si vijon:

"Degët e Bankës së shtetit shqiptar dhe degët e Bankës Bujqësore caktojnë, brenda këtyre kufijve, afate të diferencuara për çdo ndërmarrje, institucion, kooperativë bujqësore e organizatë shoqërore, në përputhje me kushtet e veprimtarisë së tyre."

- Pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Faturat që paraqiten jashtë afateve të mësipërme, pranohen nga banka, kur ka shkaqe të arsyeshme, por jo më vonë se afatet e parashkrimit. Për raste të tjera faturat pranohen nga banka, pasi të nxirret përgjegjësia ndaj personave shkaktarë për paraqitjen e tyre me vonesë".

Neni 3

Në nenin 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në komisionin e verifikimit të vlerave materiale nuk caktohen punëtorë të magazinave".

Neni 4

Neni 8 ndryshohet si vijon:

"Kur ka mospërputhje ndërmjet sasive të mallrave të shënuara në fletëdalje, në faturat ose në dokumentet e tjera shoqëruese, dhe sasive efektive që gjenden brenda ambalazhit, si dhe në cilësi, llojshmëri, qënien e plotë dhe markën e prodhimit, veprohet si vijon:

a) Kur shitësi dhe blerësi ndodhen në të njëjtin qytet, komisioni ndërpret verifikimin dhe; brenda ditës së konstatimit të mospërputhjes, lajmëron shitësin, i cili detyrohet të paraqitet brenda 24 orëve nga data e njoftimit.

b) Kur shitësi dhe blerësi nuk ndodhen në të njëjtin qytet, komisioni ndërpret verifikimin dhe, brenda ditës së konstatimit të mospërputhjes, lajmëron shitësin, i cili detyrohet të paraqitet brenda 3 ditëve nga data e njoftimit.

Kur shitësi nuk paraqitet brenda afateve të mësipërme për të parë gjendjen dhe për t'i dhënë rrugë veprimit, komisioni vazhdon verifikimin.

Kur nga verifikimi del se mallrat janë të një cilësie më të ulët nga ato që janë faturuar dhe nuk mund të përmirësohet cilësia e tyre, nuk i kthehen shitësit, por rivlerësohen sipas rregullit dhe vihen në përdorim me çmime të reja. Deferencat dhe rivlerësimi rëndojnë mbi shitësin".

Neni 5

Paragrafi i dytë i nenit 9 ndryshohet si vijon:

"Llojet e mallrave që prishen shpejt dhe me qëndrueshmëri mesatare, përcaktohen nga ministritë prodhuese".

Neni 6

Në nenin 10, pas shkronjës "a", shtohet shkronja "a/1" me këtë përmbajtje:

"Për mallrat me qëndrueshmëri mesatare, brenda 3 ditëve".

Neni 7

Në nenin 11 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për mallrat e importit rivlerësimi bëhet në bashkëpunim me ndërmarrjen përkatëse të tregëtisë së jashtme, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit".

Neni 8

Në nenin 17, në pikën 1, pas shkronjës "c", shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"Kur pjesët e ndërrimit nuk gjejnë përdorim ngaqë makinat ose pajisjet, të cilave u përkasin, nuk janë më në përdorim dhe kur nuk mund të përshtaten për makineri e pajisje të tjera, si dhe kur nuk do të gjejnë përdorim edhe në të ardhmen".

Neni 9

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

- Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Inventari i imët, ambalazhet, materialet dhe mallrat nxirren jashtë përdorimit me urdhër të drejtuesit të ndërmarrjes, të institucionit ose organizatës shoqërore, pavarësisht nga vlefata e tyre, pasi të jetë marrë edhe mendimi i këshillit tekniko-ekonomik.

- Në pikën 5, në shkronjën "b", shuma 20 mijë lekë të bëhet 50 mijë lekë; në shkronjën "c", shuma 10 mijë lekë të bëhet 30 mijë lekë dhe shuma 20 mijë lekë të bëhet 50 mijë lekë; në shkronjën "ç", shuma 10 mijë lekë të bëhet 30 mijë lekë.

Neni 10

Në nenin 23 shkronja "a" ndryshohet si vijon:

"Kur janë në ambalazh të mbyllur standard dhe me shenjën e fabrikës, si numër pakosh, thasësh, kontejnerësh, lidhjesh, arkash, paletash e slinkerësh.

Disa mallra të konsumit të gjerë që do të caktohen nga Ministria e Tregëtisë së Brendëshme në bashkëpunim me Ministrinë e Transporteve, duke marrë edhe mendimin e

ministrisë prodhuese, kur transportohen drejtpërdrejtë me transport automobilistik, do të merren në dorëzim e dorëzohen edhe me peshimin e tyre bruto".

Neni 11

Në nenin 24, fjalia e parë në paragrafin e parë ndryshohet si vijon:

"Kolitë që kanë shenja hapjeje ose që u mungon etiketa me shenjën dalluese e me nënshkrimin e ambalazhuesit, pritësi i merr në dorëzim nga transporti vetëm pasi verifikon peshën neto ose numrin e njësive dhe përmbajtjen brenda ambalazhit".

Neni 12

Neni 29 ndryshohet si vijon:

"Vlerat materiale të marra në dorëzim nga transportuesit dhe të padorëzuara pritësit quhen të humbura, me kalimin e këtyre afateve:

a) Në transportimet e drejtpërdrejta 10 ditë pas afatit të caktuar në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 26.

b) Në transportimet e përziera 30 ditë pas kalimit të afatit të caktuar në shkronjën "c" të nenit 26".

Neni 13

Në nenin 30 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Transportuesi detyrohet t'i kthejë shitësit edhe shpenzimet përkatëse të transportit për diferencën e mallrave që nuk ka transportuar efektivisht".

Neni 14

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Për vonesat në dorëzimin e ngarkesës tej afateve të caktuara transportuesi i parë i paguan dërguesit 2 lekë për çdo ton-ditë mall të vonuar".

Në fund shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kur për diferencat e dëmtimet nuk mund të nxirret përgjegjësia ndaj shkaktarëve në bazë të vendimit të arbitrazhit ose gjykatës, kalimi në rezultat bëhet me urdhër të drejtuesit të ndërmarrjes e të Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave dhe miratohet nga organi që bën miratimin e dhënies së llogarisë".

Neni 15

Neni 32 ndryshohet si vijon:

"Pagesat ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave bujqësore dhe organizative shoqërore për mallrat e blera dhe për punimet e shërbimet e kryera bëhen me anë të Bankës me kalim në llogari, nëpërmjet këtyre formave:

a) me kërkesë arkëtimi;

b) me urdhërkalim;

c) me pagesë të planifikuar;

ç) me pagesë të garntuar;

d) me kompesim të detyrimeve ndërmjet palëve;

dh) me çek.

Kriteret dhe rregullat për zbatimin e formave të pagesave caktohen nga Drejtoria e

Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse".

Neni 16

Në nenin 34 bëhen këto ndryshime:

- Në shkronjën "ç" shtohen fjalët "dhe etiketën e kolisë që del me diferencë".
- Në paragrafin e dytë të shkronjës "d", pas fjalëve "nga Ministria e Financave", shtohen fjalët "dhe Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar".

Neni 17

Neni 38 ndryshohet si vijon:

"Dega e Bankës së Shtetit dhe dega e Bankës Bujqësore kalojnë detyrimet e ndërmarrjeve, të institucioneve, kooperativave dhe organizatave shoqërore nga llogaritë e tyre shlyese, rrjedhëse, buxhetore, sipas radhës kronologjike".

Neni 18

Në pasqyrën nr.1 shtohet pika 7/1 me emërtimin: "Ferrokromi merret në dorëzim dhe dorëzohet me peshë".

Në pasqyrën 1 e 2, paragrafi i dytë i shënimeve ndryshohet si vijon:

"Të gjitha llojet e mineraleve e koncentreve, kur lëvizin me transport të drejtpërdrejtë automobilistik, merren në dorëzim dhe dorëzohen me peshimin e tyre bruto.

Ky ndryshim do të zbatohet me caktimin e firove ligjore dhe krijimin e organizmit të pavarur të peshëmatjes e të lagështisë".

Në pasqyrën n.1 shkronja "ç" e pikës 13 ndryshohet si vijon:

"drutë e zjarrit merren në dorëzim dhe dorëzohen sipas marrëveshjes".

- Në pasqyrën nr.2, në pikën 10, në shkronjën "b" hiqen fjalët "drutë e zjarrit" dhe pas kësaj shkronje shtohet shkronja "b/1" me emërtimin: "drutë e zjarrit merren në dorëzim dhe dorëzohen sipas marrëveshjes".

Neni 19

Nenet 39, 40 dhe 41 shfuqizohen.

Neni 20

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI